

VENDIM ASAMBLEJE

DATE 21.07.2023

PËR

“VLERESIMIN E FITIMIT TE PASHPERNDARE DHE ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTARE “

Mbështetur në Nenin 81, pika 1/e,ë,ç te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë Tregtare”, Nenin 43 te ligjit 9723,date 03.05.2007“Per Qendren Kombetare te Biznesit”I ndryshuar, Nenin 33/1 të Ligjit Nr 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të ardhurat” I ndryshuar; Statutin i Shoqërisë “LIM-EM “ shpk;

Në Tiranë, sot më datë 21.07.2023 në selinë e shoqërisë “LIM-EM “shpk,u mbledh asambleja e Ortakeve të kësaj shoqërise, e cila pasi ka miratuar në mbledhjen e mëparshme të ortakëve të shoqërisë rezultatet financiare të vitit ushtrimor 2022, mori sot në shqyrtim në rendin e ditës,

Shqyrtim i Raportit te Audituesit Ligjor te dates 20.07.2023,pergatitur nga Znj .Erminda Gjondeda,per Vleresimin e fitimeve te pashperndara dhe fitimit te vitit ushtrimore 2022,te cilat do te perdoren per Zmadhimin e Kapitalit Themeltare te Shoqërise .

Asambleja e Ortakeve me pjesmarje te Z.Shkelqim Beshiri dhe Z.Ardian Beshiri, pasi u njoh me rendin e dites :

VEREJTI SE :

1. Kapitali Themeltare i kesj shoqërie aktualisht eshte 1,089,326,746 leke .Ky kapital perbehet nga 2 kuota dhe eshte i ndare ne kete menyre:
 - a) Z.Shkelqim Beshiri zoteron nje kuote te barabarte me 50 % te vleres se Kapitalit Themeltare, e barabarte me 544,663,373 leke .
 - b) Z.Ardian Beshiri zoteron nje kuote te barabrate me 50 % te vleres se Kapitalit Themeltare e barabarte me 544,663,373 leke .





2. Me Vendimin e date 03.07.2023,Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ka proceduar konform dispozitave ligjore për shtesën e Kapitalit Themeltarë,duke caktuar Znj.Erminda Gjondeda,Auditues Ligjor e pajisur me Licence Nr 312.date 28.03.2014,për vlerësimin e fitimit të pashpërndarë të shoqërisë,gjendje me date 31.12.2022 me të cilin do të shtohet kapitali themeltarë.

Ne analize të rendit të ditës :

Asambleja e ortakëve të kësaj shoqërie,pasi njihet me Raportin e Audituesit Ligjor të datës 20/07/2023,pergatitur nga Znj,Erminda Gjondeda për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara dhe fitimin e ushtrimit të vitit 2022,gjendje me 31.12.2022 me të cilin do të bëhet zmadhim i Kapitalit Themeltarë të shoqërisë ,verën se ky raport është i drejtë ,në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për këtë arsye duhet miratuar nga Asambleja e Ortakëve .

Sipas këtij raporti,Kapitali Themeltarë i Shoqërisë pas këtij zmadhimi në shumën 322,492,107 leke bëhet nga 1,089,326,746 leke në 1,411,818,853 leke

Shtesa e Kapitalit Themeltarë në shumën 322,492,107 leke dhe shtesa e rezervës ligjore në shumën 3,670,488 leke do të realizohet me fitimet gjendje me 31.12.2022.Pas këtyre shtesave,fitimet e mbartura dhe ai i ushtrimit 2022 do të përdoren 100 % .

Per keto arsye , Asambleja e Ortakëve ,me votim unanim “

VENDOSI

- 1. Miratimin e Raportit të Audituesit Ligjor,date 20.07.2023 “Për Vlerësimin e Fitimeve të Pashpërndara me të cilat do të Zmadhohet Kapitali Themeltarë i shoqërisë,pergatitur nga Znj.Erminda Gjondeda .**
- 2. Zmadhimin e Kapitalit Themeltarë të kësaj shoqërie në shumën 322,492,107 i cili pas kësaj shtese bëhet nga 1,089,326,746 leke në 1,411,818,853 leke .**
- 3. Shtimin e rezervës ligjore në shumën 3,670,488 leke e cila nga 6,223,652 leke bëhet 9,894,140 leke**
- 4. Zoterimi i Kapitalit Themeltarë pas zmadhimit do të bëhet në këto mënyre :**
 - Z . Shkelqim Beshiri 50 % të kuotave në kapital ,e barabartë me 705,909,426.5 leke**
 - Z. Ardian Beshiri 50 % të kuotave në kapital e barabartë me 705,909,426.5 leke**
- 5.Për zbatimin e këtij vendimi dhe përcjelljen e tij në institucionet përkatëse ngarkohet përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “LIM-EM SHPK ” shpk**
- 6.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETEM:

Shkelqim Beshiri



Ardian Beshiri

